



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 425, datë 12.10.2020

PËR

**MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR Z.FATBARDH ÇONIKU,
GJYQATAR I GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN,
I KOMANDUAR PRANË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikat 1 dhe 2, të nenit 65, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit mbi motivin “*arritjes së moshës së pensionit*”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z.Fatbardh Çoniku, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të dorëheqjes së tij.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 30.11.2020.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit Fatbardh Çoniku sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR